

20130150582

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PËR BUJQESI
DHE ZHVILLIM RURAL

Neni 1

Në Ligjin për bujqesi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 49/10, 53/11 dhe 126/12), në nenin 2 pas pikes 32 shtohen dy pika të reja 33 dhe 34, si vijojne:

„33. **Lidhshmeri kapitale** është posedimi i drejtperdrejte apo i terthorte, kontrolli apo mbajtja e 5% ose më shume aksioneve apo pjesemarrjeve të emetuara me të drejte vote, nga një subjekt në tjetër.

34. **Lidhshmeri familjare** është lidhshmeria e personave që konsiderohen anetare të familjes së njejte dhe janë në farefisni si vijon: burra dhe grua; prind dhe femije; vella dhe moter (qofte farefisni e plote ose gjysmegjaku); gjyshe apo gjysh dhe nipër, xhaxha, dajë, burra i tezes, grua e axhes, grua e dajës apo teze dhe nip ose mbese; prinderit e bashkeshortëve dhe dhender apo nuse; kunat, mik apo baxhanak dhe kunate, nuse, kunate ose mik;”.

Pikat 33 dhe 34 behen pika 35 dhe 36

Neni 2

Në nenin 14 paragrafi (1) pas fjales "shfrytëzues" shtohen fjalet: "dhe kooperativa bujqesore të regjistruara në pajtim me Ligjin për kooperativa bujqesore".

Neni 3

Neni 15 ndryshohet si vijon:

"(1) Ministria mban regjister unik të ekonomive bujqesore (në tekstin e metejme: RUEB).

(2) Në RUEB detyrimisht regjistrohen ekonomite bujqesore, të cilat:

1) kerkojne realizim të së drejtes për shfrytëzim të mjeteve nga masat në perputhje me kete ligj dhe

2) janë të regjistruara në regjistrat e formuar në pajtim me ligjet nga sfera e bujqesise, blegtorise, peshkatarise dhe akuakultures, veterinarise, sigurise së ushqimit dhe shendetit dhe mbrojtjes së bimeve.

(3) Baze për mbajtjen e RUEB dhe lidhjen e tij me regjistrat tjere është numri unik identifikues i ekonomise bujqesore (në tekstin e metejme: NRID).

(4) NRID percaktohet gjate regjistrimit të ekonomise bujqesore në RUEB, me ç’rast një ekonomie bujqesore i ndahet një NRID.

(5) Perdorimi i NRID është i detyrueshem në të gjitha regjistrat e formuar në pajtim me ligjin.

(6) Bartesi i ekonomise bujqesore familjare dhe anetaret e ekonomise bujqesore familjare janë të lidhur familjarisht dhe mund të regjistrohen vetem në një ekonomi bujqesore familjare në regjistrin nga paragrafi (1) i ketij neni.

(7) Bartesi i ekonomise bujqesore familjare është anetar i ekonomise bujqesore familjare që është i autorizuar nga anetaret tjere të ekonomise bujqesore familjare.

(8) Vendbanimi i bartesit dhe anetareve të ekonomise bujqesore familjare detyrimisht është në adresen e njejte të jeteses.

(9) Në rast kur adresa e jeteses është edhe seli e personit juridik bartes i ekonomise bujqesore regjistrohet një ekonomi bujqesore në regjistrin nga paragrafi (1) i ketij neni.

(10) Një person juridik mund të jete i regjistruar si bartes i një ekonomie bujqesore.

(11) Nese një person juridik bartes i ekonomise bujqesore merr pjese në strukture pronesore të personit tjetër juridik bartes i ekonomise bujqesore, perkatesisht ekziston lidhshmeri kapitale ndermjet personave juridike bartes të ekonomive bujqesore, në RUEB regjistrohen si një ekonomi bujqesore.

(12) Bartesi i ekonomise bujqesore detyrohet që çdo ndryshim të të dhenave në RUEB ta paraqese në Ministri në afat prej 15 ditësh nga ndryshimi i krijuar.

(13) Kerkese për ndryshimin e të dhenave në regjistrin unik të ekonomive bujqesore mund të parashtroje edhe anetari tjetër i autorizuar i ekonomise bujqesore familjare nga radhet e trashëgimtareve të prones bujqesore të ekonomise bujqesore familjare në rast të vdekjes së bartesit të ekonomise bujqesore familjare.

(14) Kerkese për ndryshimin e të dhenave në regjistrin unik të ekonomive bujqesore për ekonomi bujqesore bartes i së ciles është person juridik, mund të parashtroje personi i autorizuar i personit juridik-bartes i ekonomise bujqesore ose perfaqesuesi i autorizuar i personit juridik-bartes i ekonomise bujqesore.

(15) Me përjashtim nga paragrafet (12), (13) dhe (14) të këtij neni, ndryshimi i të dhenave në RUEB mund të kryhet në baze të të dhenave nga mbikeqyrja inspektuese e Inspektoratit Shtetëror të Bujqesise, kontrollit të kryer nga Agjencia në baze të kërkesave të pranuar për shfrytëzim të mjeteve në pajtim me kete ligj, kontrollit të kryer nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarise dhe në baze të të dhenave nga Sistemi i integruar për administrate dhe kontroll.

(16) Ministria leshon aktvendim për regjistrim dhe aktvendim për shlyerje nga RUEB.

(17) Për ndryshimin e të dhenave në RUEB, Ministria leshon aktvendim të ri për regjistrim në RUEB.

(18) Permbajtjen dhe formen e aktvendimit për regjistrim në RUEB dhe aktvendimit për shlyerje nga RUEB i percakton ministri.

(19) Ministri i percakton llojin e të dhenave, procedurën dhe menyren e regjistrimit dhe ndarjes së NRID edhe për ndryshimin e të dhenave dhe shlyerje, permbajtjen dhe formen e formulareve dhe dokumentacionin e nevojshëm percjelles për regjistrim, ndryshimin e të dhenave dhe shlyerjen, si dhe menyren dhe afatin për manipulim, përdorim, shpallje dhe ruajtjen e të dhenave nga RUEB.

(20) Të dhenat nga RUEB shpallen në forme përmbledhese, sidomos sipas kulturave bujqesore, sipas madhësisë së ekonomive bujqesore, sipas komunave dhe në nivel të Republikës së Maqedonisë.

(21) Të drejte shikimi në të dhenat nga RUEB ka bartesi i ekonomise bujqesore familjare apo anetari tjetër i autorizuar i ekonomise bujqesore familjare ose personi i autorizuar i personit juridik – bartes i ekonomise bujqesore ose perfaqesuesi i autorizuar i personit juridik - bartes i ekonomise bujqesore në çdo kohe sipas kërkesës së parashtruar paraprakisht në Ministri ose me qasje elektronike të këtyre personave pas marrjes së qasjes shfrytëzuese paraprake nga Ministria.”

Neni 4

Pas nenit 15 shtohet nen i ri 15-a, si vijon:

"Kategorite e ekonomive bujqesore

Neni 15-a

Ekonomite bujqesore të cilat së paku 50% nga të hyrat e përgjithshme vjetore neto i realizojnë nga kryerja e veprimtarisë bujqesore kategorizohen në katër kategori, si vijon:

- kategoria e parë – ekonomi bujqesore familjare me të hyra vjetore neto të realizuara nga kryerja e veprimtarisë bujqesore deri në shumën e shumës vjetore neto të rrogës minimale për vitin paraprak, në pajtim me të dhenat nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale,

- kategoria e dytë - ekonomi bujqesore familjare me të hyra vjetore neto të realizuara nga kryerja e veprimtarisë bujqesore nga shumën e shumës vjetore neto të rrogës minimale për vitin paraprak, në pajtim me të dhenat nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale deri në shumën vjetore të bazës minimale për llogaritje dhe pagesë të kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social,

- kategoria e trete - ekonomi bujqesore familjare dhe ekonomi bujqesore me të hyra vjetore neto të realizuara nga kryerja e veprimtarise bujqesore nga shuma vjetore e bazes minimale për llogaritje dhe pagese të kontributeve nga sigurimi i detyrueshem social deri në të hyra vjetore neto të realizuara nga kryerja e veprimtarise bujqesore deri në 2 000 000 denare dhe

- kategoria e katert - ekonomi bujqesore me të hyra vjetore neto të realizuara nga kryerja e veprimtarise bujqesore mbi 2 000 000 denare."

Neni 5

Në nenin 30 paragrafi (5) ndryshohet si vijon:

"Ekonomia bujqesore familjare e blesit të regjistruar në regjistrin nga neni 33 i ketij ligji, detyrohet që shitjen ta kryeje në baze të marreveshjes me shkrim të lidhur në perputhje me nenin 32 të ketij ligji."

Neni 6

Në nenin 31 paragrafi (6) alineja 4 fjalet: "disponojne me" zevendesohen me fjalet: "kane në pronesi".

Neni 7

Në nenin 74 paragrafi (3) pas alinese 2 shtohet aline e re 3, si vijon:

"- aktivitete tjera në pajtim me kete ligj ose në pajtim me Ligjin për kooperativa bujqesore,".

Në paragrafin (4) pas alinese 1 shtohet aline e re 2 , si vijon:

"- kooperative bujqesore e regjistruar sipas Ligjit për kooperativa bujqesore,".

Paragrafi (5) ndryshohet si vijon:

"Lloji i perkrahjes nga paragrafi (3) i ketij neni, lloji i shfrytezuesve nga paragrafi (4) i ketij neni, lartesia e perkrahjes dhe kushtet e peraferta për shfrytezimin e ndihmes në drejtim të realizimit të qellimeve nga paragrafi (2) i ketij neni dhe lloji i mekanizmit të perkrahjes nga neni 92 i ketij ligji, rregullohet me programet nga neni 7 i ketij ligji dhe/ose me Ligjin për kooperativa bujqesore."

Paragrafet (6) dhe (7) shlyhen.

Në paragrafin (8) i cili behet paragraf (6) fjalet: "paragrafi (6)" zevendesohen me fjalet: "paragrafi (3)".

Paragrafi (9) i cili behet paragraf (7) ndryshohet si vijon:

"(7) Perkrahja nga paragrafi (3) i ketij neni ndahet në baze të planit të miratuar afarist të formes organizative të pergatitur për periudhe të planifikimit prej së paku pese vjet."

Paragrafi (10) i cili behet paragraf (8) ndryshohet si vijon:

"(8) Në planin afarist duhet të permbahen vecanerisht aktivitetet në vijim:

- aktivitete investuese për perparimin e potencialit fizik të formes organizative nga paragrafi (4) i ketij neni dhe/ose të ekonomive bujqesore - themelues/anetare për prodhimtari bujqesore dhe/ose për investime në magazinim perpunim plotesues dhe marketing dhe

- aktivitete informative dhe promovuese për prodhimet bujqesore që i prodhon."

Paragrafet (11), (12) dhe (13) behen paragrafe (9), (10) dhe (11).

Neni 8

Në nenin 90 paragrafi (1) pas fjaleve: "kapacitete prodhuese", shtohen fjalet: "lloji i veprimtarise dhe rezultatet e arritura financiare".

Në paragrafin (2) numrat "70, 71, 72, 73, 81, 86 dhe 87" zevendesohen me fjalet: "70, 71, 72, 73, 74, 81, 86 dhe 87".

Neni 9

Neni 106 ndryshohet si vijon:

"(1) Ndhime për vendosjen e standardeve më të larta të cilesise së prodhimeve bujqesore ndahet për vendosje dhe mirembajtje të standardeve më të larta në vijim të cilesise së prodhimeve bujqesore:

- prodhimtari organike,
- mbrojtje e prodhimeve bujqesore dhe ushqimore me emer gjeografik ose tradicional dhe
- standarde për sigurine në prodhimtarine bujqesore primare.

(2) Ndhima nga paragrafi (1) i ketij neni mund të ndahet në forme të:

- ndihmes plotesuese financiare deri 1 denar për njesi prodhime bujqesor të perdorur si lende e pare për prodhime me cilesi më të larte në pajtim me ligjin,

- ndihme financiare për kompensim të shpenzimeve për vendosje ose për aplikim të shenjave për cilesine në shumen maksimale deri 300 000 denare ose 5% të vleres së prodhimeve bujqesore të shitura me standarde më të larta të cilesise, por jo më shume se 300 000 denare,

- ndihme financiare për shpenzimet për regjistrim të shenjave të mbrojtura me emrin gjeografik apo tradicional,

- ndihme financiare për kontroll dhe certifikim të prodhimtarise organike dhe/ose shenja të mbrojtura me emer gjeografik apo tradicional,

- ndihme financiare për perpilimin e elaboratit ose specifikim për regjistrim të shenjave të mbrojtura me emrin gjeografik apo tradicional

- ndihme plotesuese deri 20% të pagesave të drejtperdrejta për standarde të zbatuara për siguri dhe

- ndihme financiare për shpenzime për analiza laboratorike dhe certifikim gjate vendosjes dhe mirembajtjes së standardeve për siguri në prodhimtarine primare bujqesore.

(3) Shfrytëzuesit dhe lartesia e perkrahjes percaktohen me programet nga neni 7 i ketij ligji."

Neni 10

Në nenin 112 fjalet: "kooperative e formuar" zëvendësohen me fjalet: "person juridik me veprimtari nga sfera e bujqesise i formuar".

Neni 11

Në nenin 114 paragrafi (1) në fjaline hyrese, fjala "koperativa" zëvendësohen me fjalet: "personi juridik".

Alineja 1 ndryshohet si vijon:

"- të jete i regjistruar si person juridik me veprimtari në sferen e bujqesise në pajtim me Ligjin për shoqeri tregtare ose Ligjin për kooperativa ose Ligjin për kooperativa bujqesore,".

Në paragrafin (2) fjala "Kooperativa" zëvendësohet me fjalet: "Personi juridik".

Neni 12

Në nenin 121 paragrafi (1) alineja 2 fjala "kooperatives" zëvendësohet me fjalet: "personit juridik".

Neni 13

Në nenin 122 paragrafi (1) fjala "koperative" zëvendësohet me fjalet: "personi juridik".

Në paragrafin (2) në fjaline hyrese, fjala "kooperativa" zëvendësohet me fjalet: "personi juridik".

Alineja 1 ndryshohet si vijon:

" - të jete i regjistruar si person juridik me veprimtari nga sfera e bujqesise në pajtim me Ligjin për shoqeri tregtare ose Ligjin për kooperativa ose Ligjin për kooperativa bujqesore,".

Në paragrafin (3) fjala "kooperativa" zëvendësohet me fjalet: "personi juridik".

Neni 14

Në nenin 124 paragrafi (3) alineja 1 fjala “kooperatives” zëvendësohet me fjalet: ”personit juridik”.

Neni 15

Në nenin 128 paragrafi (1) alineja 2 fjala “kooperatives” zëvendësohet me fjalet: “personit juridik”.

Neni 16

Në nenin 135 paragrafi (1) fjala “kooperativa” zëvendësohet me fjalet: “Personi juridik”.
Në paragrafin (2) alineja 5 fjala “kooperativa” zëvendësohet me fjalet: “personi juridik”.

Neni 17

Në nenin 145 paragrafi (1) alineja 1 fjalet: “për siperfaqe” shlyhen.
Alineja 2 shlyhet.
Në paragrafin (5) numri “146” zëvendësohet me numrin “147”.

Neni 18

Në nenin 150 paragrafi (1) pas fjales “përkrahje” vihet pike, ndërsa fjalet deri në fund të fjales shlyhen.

Neni 19

Në nenin 158 në fjaline hyrese fjala “kooperatives” zëvendësohet me fjalet: “personit juridik”.

Neni 20

Në nenin 166 pas alinës 2 shtohet aline e re 3, si vijon:
“- kryejne shitje pa marreveshje të lidhur me shkrim (neni 30 paragrafi (5)),”.

Neni 21

Rregullat e përafërta të përcaktuara në këto ligj do të miratohen në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
Deri në ditën e hyrjes në fuqi të rregullave nga paragrafi 1 i këtij neni do të zbatohen rregullat ekzistuese.

Neni 22

Procedurat e filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdojnë në pajtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numer 49/10, 53/11 dhe 126/2012).

Neni 23

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, ndërsa dispozitat e nenit 3 paragrafet (9), (10), (11), (16), (17) dhe (18) të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2014.